



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 203/7 prot.

Tiranë, më 10.6.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.5.2020 është njoftuar vendimi nr. 231, datë 29.1.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me caktim të përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit z. Anton Martini, aktualisht me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me caktim të përkohshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, me përparësi në

kohë si kandidat për prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme (*në vijim referuar si GPPP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Anton Martini*”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017<sup>2</sup>, në të cilin parashtrohet fakti se vlerësimi është kryer në mungesë të informacionit nga ana e SHISH-it, i ka referuar Komisionit: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Anton Lazër Martini*”.

2.2.1 Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2019, drejtuar DSIK-së ka kërkuar përditësimin e Raportit nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017, për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini, duke përfshirë në të edhe informacionet e marra nga SHISH.

2.2.2 Në përgjigje të shkresës së mësipërme, DSIK, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2019,<sup>3</sup> drejtuar Komisionit, konfirmon konstatimin fillestar për: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Anton \*\*\* Martini*.

2.3 **GPPP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dosjeve të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale.

3. Për shkak të administrimit më datë 11.12.2019 (1 ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore) të një denoncimi të ri për subjektin e rivlerësimit, Komisioni vendosi riçeljen e

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*\*.10.2018.

<sup>3</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr.\*\*\*, datë \*\*\*.7.2020.

hetimit administrativ për z. Anton Martini dhe në datën 15.1.2020, i njoftoi subjektit të rivlerësimit rezultatet shtesë të hetimit administrativ. Subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datën 21.1.2020.

**4.** Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

**4.1 Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Gjithashtu, në lidhje me kredinë e përfuturuar në vitin 2007, Komisioni vlerëson se përdorimi i mjeteve monetare të përfuturuar me anë të kredisë, me kritere lehtësuese nga subjekti dhe të përdorura për blerjen e bonove të thesarit, duke siguruar të ardhura për përballimin e qirasë së shtëpisë dhe të kësteve të kredisë, nuk përputhen me etikën e prokurorit dhe duket sikur e cenon atë. Nga ana tjetër, pasi analizoi qëllimin e përdorimit të kësaj kredie, masën e të ardhurave të siguruara, mënyrën e përdorimit të tyre, Komisioni arrin në konkluzionin se kjo shkelje nuk mund të jetë shkak i mjaftueshëm për shkarkimin e subjektit. Një rast i shkëputur nuk mund të jetë cenim i etikës së prokurorit, sidomos duke vënë në balancë rezultatet profesionale të punës së tij si prokuror i Krimeve të Rënda (f. 31 e vendimit). Në këto kushte, shumica e trupit gjykues të Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016.*

**4.2 Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës [...] (f. 32 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.*

**4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga GPPP, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i

rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional [...]* (f. 49 e vendimit). Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**5. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në pikën 5 të nenit 55, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash,<sup>4</sup> ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**6.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**7.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**8.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni 4 i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**9.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**10.** Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 231/2020, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohet në vijim, ky ankim i referohet jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor i procesit, që vendos për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit.

**11.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim,

---

<sup>4</sup> Vendimi nr. 231/2020 është marrë me shumicë votash, pasi anëtarja e trupit gjykues znj. Etleda Çiftja ka dalë në pakicë dhe ndan mendim të kundërt me anëtarët e tjerë të trupit gjykues.

rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: (i) deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të pasurisë; (ii) rezultatet e hetimit mbi vlerësimin profesional, konkretisht: (a) lidhur me të dhënat e burimeve arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe (b) të dhëna mbi mangësi procedurale të dosjeve të shortuara, pjesë e Raportit Profesional për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini; (iii) rezultatet shtesë të hetimit mbi të dhënat e denoncimit të datës 11.12.2019.

**12.** Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

**13.** Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### **III.A. Kontrolli i pasurisë**

**14.** Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

**15.** Nga aktet e administruara rezulton se:

**15.1** Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka deklaruar:

**15.2** Shtëpi banimi me adresë rruga: “\*\*\*.\*\*\*”, pallati “\*\*\* & \*\*\*”, ap. nr. \*\*\*, Tiranë, me sip. banimi 97,16 m<sup>2</sup>, sip. të përbashkët 10,74 m<sup>2</sup>, sip. tarrace 25,95 m<sup>2</sup>, si dhe një post garazhi, me vlerë totale 90.000 euro.

**15.3** Në lidhje me: (a) titullin e pronësisë dhe (b) burimin e krijimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Kjo banesë akoma nuk është regjistruar në ZVRPP në emrin tim, por me kontratën e porosisë datë 14.4.2015, bërë te notere \*\*\*.\*\*\*, me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., kam porositur këtë banesë, ku paraprakisht në momentin e hartimit të kësaj kontrate, kam paguar cash te ndërtuesi, në prani të noterës, shumën prej 50.000 euro. Më pas, më datë 13.1.2017, kam derdhur në llogarinë e firmës ndërtuese, pranë \*\*\* Bank shumën prej 35.000 eurosh. Mbetem për t’i paguar në momentin e kalimit të pronësisë së objektit edhe një shumë tjetër prej 5.000 eurosh. Vlera e deklaruar: 85.000 euro. Pjesa takuese: 50% [...]*

**15.4** Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar po ashtu: [...] *Shpenzime arredimi të banesës në vlerën 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50% [...]*.

**15.5** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së lartpërmendur dhe shpenzimeve të arredimit është deklaruar si më poshtë: [...] *(i) Kredia e marrë nga \*\*\* Bank sh.a. në shumën*

prej 5.000.000 lekë në vitin 2007, me afat shlyerje 25 vjet; (ii) Kredia e marrë sërish nga \*\*\* Bank sh.a., në shumën prej 5.200.000 lekësh në vitin 2016, me afat shlyerje 15 vjet; (iii) Të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga puna jonë ndër vite [...].

15.6 Në DV- 2015, për të njëjtën pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Porositur apartament më datë 14.4.2015, me kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me adresë Rr: “\*\*\*.\*\*\*”, nr.\*\*\*, Tiranë. Notere \*\*\*.\*\*\* Paguar shuma 50.000 euro për vitin 2015, detyrimi i mbetur 40.000 euro. Vlera: 90.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Mbyllja e Fondit të Investimit në “\*\*\* Invest” dhe nga pakësimi i gjendjes cash, të kursyer ndër vite deri në vitin 2014 [...].*

15.6.1 Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” të DV- 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Me kontratën e porosisë datë 14.4.2015, bërë te notere \*\*\*.\*\*\*, me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., kam porositur një shtëpi banimi me adresë rruga “\*\*\*.\*\*\*”, nr.\*\*\*, Tiranë, ku paraprakisht në momentin e hartimit të kësaj kontrate kam paguar cash te ndërtuesi në prani të noterës shumën prej 50.000 eurosh. Mbetet për të paguar nga ana ime dhe shuma prej 40.000 euro dhe vlera e një garazhi, e cila nuk është përcaktuar akoma, të cilat do të paguhet me këste deri në momentin e marrjes së hipotekës së banesës [...].*

**16.** Lidhur me deklarin e plotë të pasurisë se paluajtshme të mësipërme, referuar korrespondencës<sup>5</sup> së Komisionit me ZVRPP Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë e llojit “apartament” me sip. 97,16 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, faqe \*\*\*, z. k. \*\*\*, Tiranë.

16.1 Bazuar në përmbajtjen e kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë 17.11.2017, (referohuni nenit 2 dhe 5 të kontratës së shitblerjes), që përfaqëson titullin e pronësisë së subjektit të rivlerësimit, lidhur midis shoqërisë “\*\*\* & \*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe z. Anton Martini, në cilësinë e blerësit, rezulton se këtë pasuri pala blerëse e ka përfituar nga pala shitëse, sipas kushteve të kontratës noteriale së porosisë, nënshkruar mes tyre me nr. \*\*\* rep. /\*\*\* kol., datë 17.4.2015, duke paguar blerësi vlerën totale të shitblerjes prej 90.000 eurosh, sipas kushteve dhe afateve të dakordësuara mes palëve në kontratën e porosisë.

16.2 Kontrata e porosisë nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë 17.4.2015, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shoqërisë “\*\*\*\* & \*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe subjektit të rivlerësimit z. Anton Martini, në cilësinë e porositësit, ka si objekt porositjen [...] e një apartamenti banimi me nr. \*\*\*, në katin e pestë, me sipërfaqe totale 107,9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët 10,74 m<sup>2</sup>, sipërfaqe apartamenti ndërtimi 97.16 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe tarrace 25,95 m<sup>2</sup>, dhe të një posti garazhi. Çmimi i pasurisë së porositur nga porositësi dhe i pranuar nga sipërmarrësi është në vlerën 90.000 euro [...].

16.3 Në nenin 4, “*Mënyra e pagesës*”, të Kontratës së Porosisë, datë 17.4.2015, rezulton se deri në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate pala porositëse ka paguar për llogari të shoqërisë së ndërtimit këstin prej 50.000 eurosh. Pjesa e mbetur prej 40.000 eurosh do të paguhet me marrëveshje mes palëve, e ndarë në këste, deri në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes mes palëve.

<sup>5</sup> Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018 e ZVRPP-së Tiranë.

16.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, pyetjes nr. 7 të Komisionit se si janë shlyer këstet për vlerën e blerjes prej 90.000 eurosh dhe sa ka qenë detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese në datën 31.12.2016, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] (i) *Kësti i parë, me vlerë prej 50.000 eurosh, është shlyer nga unë në datën 7.4.2015, në bazë të faturës së arkëtimit datë 7.4.2015 ...* (ii) *kësti i dytë, me vlerë 35.000 euro, është derdhur në llogarinë e firmës ndërtuese pranë \*\*\* Bank, më datë 13.1.2017...* (iii) *ndërsa kësti i mbetur prej 5.000 eurosh nuk i ka kaluar akoma shoqërisë, pasi sipas kontratës së porosisë, datë 17.4.2015 ishte porositur dhe një post garazhi brenda vlerës prej 90.000 eurosh, por akoma nuk më ka kaluar në pronësi, për rrjedhojë akoma nuk ia kam kaluar këstin e fundit [...].*

16.5 Për sa më sipër, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit mbi mospërputhjet lidhur me pagesën e kryer në favor të shoqërisë sipërmarrëse, pasi, referuar kontratës së shitblerjes së pasurisë apartament (datë 17.11.2017), rezulton se është paguar vlera totale prej 90.000 eurosh, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (dërguar nga KPK më datë 5.2.2019), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si detyrim të mbetur ndaj shitësit shumë prej 5.000 eurosh.

16.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *është gabimi i noteres lidhur me deklarin e pagesës së plotë prej 90.000 eurosh, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së datës 17.7.2017, me numër \*\*\* rep./\*\*\* kol. Unë, në asnjë deklarin tim, nuk jam shprehur lidhur me pagimin e plotë të pagesës prej 90.000 eurosh kompanisë ndërtuese, pasi kemi një problem akoma të pazgjidhur lidhur me postin e parkingut. Nëse do të kisha paguar sasinë prej 90.000 eurosh më datë 17.7.2017, atëherë pala shitëse do të më kalonte dhe postin e parkingut, të cilin nuk e kam në asnjë certifikatë pronësie. Deri në atë datë, kam paguar sasinë prej 85.000 eurosh. Për parkingun jemi dakordësuar me ndërtuesin për të më siguruar një post tjetër, nga ai që më kishte rezervuar dhe deri atëherë nuk i kam kaluar sasinë prej 5.000 eurosh dhe as ai pronësinë mbi të. Për këtë kemi deklaratën noteriale të datës 19.11.2019, me numër \*\*\* rep./\*\*\* kol [...].*

16.7 Komisioni, ka konkluduar se: [...] *...Nga analizimi në harmoni i dy kontratave të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në kushtet kur: (i) nuk evidentohet pagesë tjetër e kryer nga subjekti; (ii) nuk i ka kaluar në pronësi pasuria e llojit garazh; si dhe (iii) palët me vullnetin e tyre të plotë kanë deklaruar se shuma prej 5,000 eurosh nuk është paguar ende – Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit duken bindëse dhe të provuara për pagesën e kryer deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë së llojit apartament banimi dhe vlerën e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë... subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, por vlerëson se kjo mund të ketë ardhur si rezultat i faktit se kjo kontratë është përpiluar nga e njëjta notere, e cila ka përpiluar kontratën e porosisë, sipas të cilës parashikohej kalimi në pronësi të subjektit i dy pasurive (apartamentit dhe garazhit), kundrejt pagesës prej 90,000 euro (f. 11 - 12 e vendimit).*

16.8 Komisioneri Publik çmon se këto konkluzione të Komisionit nuk janë në përputhje me përmbajtjen e provave të administruara në dosje dhe nuk bazohen në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të pasqyruara nga këto akte. Subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale e shitblerjes së pasurisë së

paluajtshme, e cila në përmbajtjen e saj përbën provë të plotë<sup>6</sup>, sa kohë rezulton e pacenuar nga palët në lidhje me shprehjen e vullnetit të tyre për kushtet e lidhjes së saj.

**17.** *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë.* Subjekti i rivlerësimit në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë së paluajtshme, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të mobilimit e të kursimeve në *cash*, shumat e ardhura nga: (i) kreditë pranë \*\*\* Bank në vitin 2007 dhe në vitin 2016, dhe (ii) kursimet nga të ardhurat nga pagat për periudhën 2003-2016.

**18.** Komisioneri Publik, duke analizuar burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në referencë të provave dhe akteve të dosjes së Komisionit, konstaton se në lidhje me:

18.1 *(i) Kredi e marrë nga \*\*\* në vitin 2007, në shumën prej 5.000.000 lekë, me afat shlyerje 25 vjet.* Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.4.2018, drejtuar Komisionit, \*\*\* Bank (në vijim \*\*\*) ka konfirmuar se z. A. Martini është kredimarrës pranë kësaj banke për: (i) kredi e marrë në datën 9.3.2007, në shumën 5.000.000 lekë, detyrimi aktual i pashlyer është 3.233.790,84 lekë.

18.2 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, me kontratën noteriale të kredisë bankare dhe hipotekë nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë 15.2.2007, kanë përfituar kredi në vlerën 5.000.000 lekë, nga \*\*\*, me qëllim blerje apartamenti.

18.3 Referuar akteve në dosjen e Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar dhe ka përfituar kredi me kushte lehtësuese në zbatim të akteve ligjore në fuqi, në lidhje me trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore.

18.4 Për sigurimin e kredisë, nga ana e subjektit janë lënë garanci hipotekore dy prona, konkretisht: (i) një apartament me sip. 90,02 m<sup>2</sup>, i ndodhur në \*\*\*, Lezhë, në pronësi të z.\*\*\*.\*\*\* dhe bashkëshortes së tij znj. \*\*\*.\*\*\* dhe (ii) një apartament me sip. 39 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Kuçovë në pronësi të z. \*\*\*.\*\*\* dhe bashkëshortes së tij znj. \*\*\*.\*\*\*.

18.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, lidhur me marrëdhënien me hipotekuesit z. \*\*\* dhe z.\*\*\* deklaroi se: [...] ... *Me shtetasin \*\*\*.\*\*\* dhe familjen e tij kam njohje prej vitesh për shkak se ka nga viti 2000 e në vijim që punon me kushëririn tim \*\*\*.\*\*\* në qytetin e Lezhës, ku e ndihmon këtë të fundit në zyrën e noterisë, pasi është noter në këtë qytet. Në vitin 2006, kur kisha nevojë për të gjetur një banesë për ta lënë si garanci në bankë për kredinë, pasi banesa e xhaxhait të nuses time, i quajtur \*\*\*.\*\*\* nuk kishte vlerë të mjaftueshme dhe duhej edhe një pronë tjetër bashkëlidhur saj, duke diskutuar me kushëririn tim \*\*\*.\*\*\* për këtë nevojë, shtetasi \*\*\*.\*\*\* më ndihmoi me një banesë të tij të sapoblerë në plazhin e \*\*\* për pushime për familjen e tij, banesë të cilën e kishte blerë nga një tjetër kushëri i imi, i quajtur \*\*\*.\*\*\* [...].*

18.6 Në lidhje me kredinë e butë në vlerën 5.000.000 lekë, referuar lëvizjeve të llogarive bankare rezulton se: (i) më datë 9.3.2007, në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit pranë \*\*\*, është disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë; (ii) më datë 11.4.2007, kjo shumë është transferuar në llogarinë bankare të pagës në emër të bashkëshortes së subjektit pranë \*\*\*, me përshkrimin “*Kalim në llogari nga Anton Martini*”; (iii) më datë 13.4.2007, bashkëshortja e

<sup>6</sup> Referuhoni në prg. 35 të vendimit (JR) nr. 5/2019 të KPA-së.



subjektit ka transferuar shumën prej 5.003.500 lekësh për të investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë.

18.7 Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. \*\*\*, të datës \*\*\*.4.2018, konfirmon vendosjen në bono thesari: (i) në datë 19.4.2007, të shumës 500.000 lekë, me maturim në datën 19.7.2007; (ii) në datën 26.4.2007, të shumës 4.500.000 lekë, me maturim në datën 25.10.2007; (iii) rivendosjet e shumës 2.500.000 lekë në datën 25.10.2007 dhe 24.4.2008, si dhe maturimin e kësaj shume në datën 16.10.2008.

18.7.1 Në datën 19.7.2007, shuma prej 498.791 lekësh është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë \*\*\* dhe në datën 26.10.2007 është tërhequr në *cash* nga bashkëshortja e subjektit, shuma prej 500.000 lekë<sup>7</sup>.

18.7.2 Në datën 16.10.2008, shuma prej 2.489.304 lekësh është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit pranë \*\*\* dhe në datën 5.12.2008 është tërhequr në *cash* nga bashkëshortja e subjektit, shuma prej 2.495.000 lekë.

18.8 Subjekti i rivlerësimit, në DV - 2007-2010, deklaron shtesa të kursimeve nga paga dhe shpërblimet në *cash*, respektivisht: (i) 500.000 lekë për vitin 2007; (ii) 400.000 lekë për vitin 2008; (iii) 500.000 lekë për vitin 2009; (iv) 700.000 lekë për vitin 2010 (të cilat i kanë konvertuar në euro dhe i kanë depozituar në \*\*\*, në llogari të bashkëshortes gjatë këtij viti); (v) 500.000 lekë kursime në llogarinë bankare të tij pranë \*\*\* Bank dhe të bashkëshortes së tij pranë \*\*\* dhe në *cash*, deri në datën 31.12.2011.

18.9 Nga sa më sipër, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar në DV-2007 - 2010, posedimin e likuiditeteve *cash* të tërhequra nga llogaria e kredisë gjatë viteve 2007 dhe 2008<sup>8</sup>, në vlerën totale 5.000.000 lekë.

18.10 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se [...] (i) në DV-2007 dhe DV-2008, ju nuk keni përcaktuar destinacion për shumat, përkatësisht prej 2.500.000 lekë dhe 2.495.000 lekë dhe as nuk i keni deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit përkatës këto shuma; (ii) Evidentohet mospërputhje midis deklaramit tuaj në pyetësin nr. 2 dhe dokumentacionit të administruar në dosje, pasi ju keni deklaruar se si burim për pagesën e kështit të parë ka shërbyer tërheqja e shumës prej 37.400 euro në datën 30.3.2015 në \*\*\* Invest, ndërkohë rezulton se kjo shumë nuk është tërhequr në këtë datë, por në data të ndryshme gjatë muajit prill 2015, në \*\*\*.\*\*\* Bank. Gjithashtu, në vlerësim të të dhënave të mësipërme duket se burimi i të ardhurave të deklaruara nga ana juaj për shlyerjen e shumës prej 50.000 euro, më datë 7.4.2015, ka qenë i pamjaftueshëm për vlerën prej 10.400 eurosh [...].

18.11 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ndër të tjera, ka deklaruar se:<sup>9</sup> [...]

(i) “Nisur nga konceptimi i im lidhur me kapitullin e deklaratës personale të deklaramit të pasurisë, “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër vite kam deklaruar vetëm

<sup>7</sup> Vlera prej 2.500.000 nuk rezulton më gjendje në sistemin bankar pas maturimit të saj dhe, sikundër pranohet dhe nga subjekti gjatë hetimit administrativ, është tërhequr *cash* në vitin 2007.

<sup>8</sup> Referohuni deklarameve të subjektit në seksionin të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private, në DV-2007 dhe DV-2008.

<sup>9</sup> Referohuni përgjigjeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit mbi pasurinë.

*shtesat e pasurisë të krijuara në vitin përkatës dhe jo totalit e parave cash në shtëpi. Edhe kur i jam përgjigjur pyetësorëve për shumat e parave cash në shtëpi vit pas viti, kam pasur në konsideratë shumatorët e të ardhurave të kursyera në çdo vit dhe asnjëherë nuk kam konsideruar si të ardhur kredinë, pavarësisht nëse ishte në bankë apo në banesë...”.*

(ii) *Unë jam shprehur në çdo deklaram se sasinë prej 50.000 euro, më datë 7.4.2015, e kam paguar si rezultat i sasisë prej 37.400 euro që i kishim në bankë + sasinë e parave cash. Pavarësisht se më datë 7.4.2015 harxhova më shumë nga paratë cash që kisha në shtëpi për të mbuluar shumën prej 23.000 euro, por parave cash në shtëpi për pak ditë u shtova sasinë prej 10.600 euro të tërhequra nga banka pas datës 7.4.2015 [...].*

18.12 Pas administrimit të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendimin e tij ka arsyetuar: [...] *Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka zbatuar detyrimin ligjor për deklarimin e shumës së përfutur nga kredia si detyrim financiar në \*\*\* Bank, në rubrikën e deklarimit të detyrimeve ndaj personave fizikë e juridikë, për pasojë, kjo shumë nuk do të duhej të deklarohet dhe në rubrikën e ndryshimit të pasurive, duke qenë se subjekti e kishte deklaruar marrëdhënien ligjore me të. Për më tepër, në rubrikën e shtesave dhe ndryshimeve në formularët e deklarimeve periodike pasqyrohen pasuritë në pronësi dhe në përdorim dhe jo ato që raportohen si detyrime ndaj të tretëve<sup>10</sup>. ...Komisioni, në analizë të të dhënave të mësipërme, vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me pasaktësinë e pjesshme në deklarimin e burimit për pagesën e kështit të parë duken bindëse, kjo në konsideratë të faktit se subjekti gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka dorëzuar mandatarkëtimin për pagesën e kryer në datën 7.4.2015, duke konfirmuar se kjo pagesë është kryer në këtë datë<sup>11</sup>[...].*

18.13 Komisioneri Publik, nisur nga vlera provuese që marrin deklaramet vjetore të subjekteve të rivlerësimit, në referencë të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, çmon se në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë vlerën e likuiditeteve gjendje në *cash*, jashtë sistemit bankar në lekë ose valutë të huaj, si dhe çdo ndryshim të këtyre vlerave.

18.14 Për tërheqjet nga llogaritë bankare, të cilat janë kryer në vitet 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë prej DV-ve të mëvonshme 2007-2010, posedimin e tyre *cash* në banesë. Në vijim të këtij interpretimi ligjor, shuma prej 37.400 euro, që rrjedh nga depozitimet në \*\*\* Invest në vitet 2010-2011, e deklaruar nga subjekti si e ardhur me burim fillestar kredinë e marrë në \*\*\* në vitin 2007, nuk justifikohet me burime të ligjshme.

18.15 Gjithashtu, lidhur me plotësimin e shumës 50.000 euro, në datën e pagesës 7.4.2015, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me burimin e pagesës së kështit të parë të apartamentit<sup>12</sup>.

18.16 Në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, lidhur me burimin e të ardhurave të deklaruara për shlyerjen e kështit të parë në shumën prej 50.000 eurosh, në datën 7.4.2015, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm

<sup>10</sup> Referohuni arsyetimit në f. 15 të vendimit të Komisionit, prg. 29.20.

<sup>11</sup> Referohuni arsyetimit në f 17, të vendimit të Komisionit, prg. 29.30 e në vijim.

<sup>12</sup> Referohuni lëvizjeve të llogarisë së bashkëshortes pranë \*\*\*.

lidhur me burimin e deklaruar të pagesës së këstit të parë të apartamentit, të ardhura nga kredia me kushte lehtësuese e marrë në vitin 2007.

18.17 Komisioneri Publik çmon po ashtu se edhe në kushtet kur subjekti eventualisht justifikon në kuptimin formal kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në vlerësimin e etikës të subjektit të rivlerësimit, fakti që subjekti i rivlerësimit ka përdorur për vite me radhë si investim financiar, vlerën e një kredie me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë e mbështetje financiare që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare, për të përfituar interesa nga “Bono thesari” për periudhën 2007 – 2008 dhe interesa nga depozitat bankare nga \*\*\* dhe \*\*\* Invest për periudhën 2011– 2015. Në vështrimin e Komisionerit Publik, veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për qëllim përfitimi financiar, janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një prokuror, dhe cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

18.18 Në përfundim, Komisioneri Publik, lidhur me burimin të ardhura nga kredia, përdorur për pasurinë “Apartament me sip. banimi 97,16 m<sup>2</sup>”, vlerëson se në kuptim të nenin D, pika 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, neni 61, pika 3, 5 e ligjit 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

18.19 Konkluzionet e mësipërme të Komisionerit Publik mbështeten edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit D të aneksit të Kushtetutës, në veçanti lidhur me kuptimin e *pasurisë së ligjshme* e ndërlidhur me momentin e deklarimit në deklaratat periodike të *likuiditeteve*.<sup>13</sup>

18.20 Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka trajtuar në disa vendime edhe pretendimet e ngritura lidhur me deklarimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019 në prg. 84; (JR) nr. 20/2019 në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në prg. 31.

**19.** Lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti. Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga momenti i transferimit me punë në Tiranë në vitin 2004 deri në vitin 2006, ka jetuar në shtëpinë e babait të tij. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr.1 ka deklaruar se, *me datë 8.12.2006, ka lidhur një kontratë qiraje për një banesë në adresën: rr. : “\*\*\*.\*\*\*”, pall. “\*\*\*”ap.\*\*\*, shk.\*\*\* Tiranë, adresë të cilën e kam deklaruar në të gjitha DV-të periodike pranë ILDKPKI-së në vite.*

**20.** Subjekti ka paraqitur kontratë qiraje nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë 8.12.2006, me afat 1 (një)-vjeçar, me të drejtë rinovimi, lidhur mes shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e qiradhënësit dhe znj. \*\*\*.\*\*\*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e qiramarrësit. Nga aktet në ZVRPP, rezulton se këtë banesë shtetasi \*\*\*.\*\*\*, i cili shfaqet si qiradhënës i banesës për subjektin e rivlerësimit, tri vite para se t’ia kalonte posedimin subjektit, e ka tjetërsuar ai vetë (qiradhënësi) pronësinë e kësaj banese përmes kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë 4.11.2003, te shtetësja \*\*\*.\*\*\*<sup>14</sup>.

<sup>13</sup> Referohuni në pikën 27.12.18 të prg. 27, vendim (JR) nr. 11/2019; prg.84, vendim (JR) nr.19/2019; prg.59, vendim (JR) 20/2019 dhe prg.31, vendim (JR) nr. 29/2019 të KPA-së.

<sup>14</sup> Nga përmbajtja e kontratës, duket se znj.\*\*\*.\*\*\* është e bija e z.\*\*\*.\*\*\*.

## 21. Kursime në cash gjatë periudhës 2003-2016

21.1 Në deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga DV-2003, subjekti ka deklaruar për çdo vit, kursime në *cash* me burim të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes. Kursimet në *cash* janë deklaruar si burim për mbulimin e një pjese të pagesës së këstit të parë të apartamentit në datën 7.4.2015, në shumën 12.600 euro, mbulimin e shpenzimeve të mobilimit të deklaruara në vlerën 2.000.000 lekë, si dhe për krijimin e kursimeve në *cash*, në vlerën 800.000 lekë, deklaruar në momentin e plotësimit të Deklaratës “Vetting”.

21.2 Komisioni, në konsideratë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ<sup>15</sup> dhe të dokumentacionit ligjor të administruar në dosje<sup>16</sup>, ka kryer analizën financiare për të gjithë periudhën e deklarimit nga subjekti, vitet 2003 - 2016. Nga analiza financiare paraprake, Komisionit i ka rezultuar [...] *se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, rezultojnë me balancë negative të fondeve për vitet 2004, 2009, 2010, 2011 dhe 2014, në vlerën prej 1,101,308 lekë*<sup>17</sup>. Nga analiza ka rezultuar, gjithashtu, me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitin 2015, në vlerën - 414,363 lekë,<sup>18</sup> si dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e gjendjes *cash* në datën 26.1.2017, në vlerën - 464.055 lekë [...]. Në total, pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për periudhën 2003 - janar 2017, ka rezultuar e provuar në shumën prej - **1.979.726 lekë**.

21.3 Lidhur me këtë fakt, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë argumentet dhe provat në lidhje me konstatimet e bëra, për sa i përket kriterit të pasurisë.

21.4 Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ<sup>19</sup>, Komisioni ka rikonsideruar, në analizën financiare, shpjegimet e lidhura me: (i) përfshirjen në të ardhura të ligjshme të shumave të dhuruara nga vëllezërit<sup>20</sup> sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore; (ii) shtesat e të ardhurave nga pagat si rezultat i shpërblimeve të subjektit dhe të ardhurat nga raporti i barrëlindjes së bashkëshortes; (iii) rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti gjatë shpjegimeve. Sa më sipër, pasi janë konsideruar nga Komisioni, kanë ndikuar në reduktimin e pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar për vitet 2004 - 2017 në shumën – **257.013 lekë**.

21.5 Lidhur me prapësimet e subjektit mbi përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të dhuruara nga vëllezërit, Komisioni ka arsyetuar se në përputhje me germën “f”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit, duke deklaruar për çdo rast shumën e dhuruar dhe identitetin e personit prej nga ka ardhur dhurimi. Pasi ka analizuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i

<sup>15</sup> Referohuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 5.2.2019 dhe përgjigjet e subjektit në rezultatet e hetimit mbi pasurinë.

<sup>16</sup> Referohuni fashikullit ILDKPKI, *Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, datë 25.3.2016*, mbajtur midis subjektit të rivlerësimit dhe Inspektorit të ILDKPKI-së, z.\*\*\*.\*\*\*.

<sup>17</sup> Referohuni faqes nr.10, të Rezultateve të hetimit administrativ.

<sup>18</sup> Referohuni faqes nr.12, të Rezultateve të hetimit administrativ.

<sup>19</sup> Referohuni më gjerësisht pretendimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ mbi kriterin e pasurisë.

<sup>20</sup> Deklaruar në total nga subjekti në DV periodike 2010 – 2016, në shumën 14.500 euro, nga vëllai \*\*\*.\*\*\* dhe 400 USD nga vëllai \*\*\*.\*\*\*.

rivlerësimit mbi të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, Komisioni ka arsyetuar se [...] *konstatohet se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhurimet e kryera për subjektin [...].*<sup>21</sup>

**22.** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, treguesit e analizës financiare të realizuar nga Komisioni, lidhur me gjendjen *cash*/kursimet ndër vite, duhej të bazoheshin vetëm mbi sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në DV periodike dhe jo sa ka shpjeguar subjekti i rivlerësimit gjatë trajtimit të rezultateve të hetimit administrativ<sup>22</sup>. Po ashtu në vlerësimin e Komisionerit Publik, aktet e paraqitura nga subjekti mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait *\*\*\*.\*\*\** nga punësimi në Britaninë e Madhe, nuk provuan të kundërtën e barrës së provës, dhe rrjedhimisht nuk duheshin konsideruar si të ardhura në treguesit financiarë të analizës së kryer.

**22.1** *Lidhur me deklaratat e subjektit në DV periodike mbi kursimet në cash*, Komisioneri Publik nënvizon se deklaratat periodike vjetore kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit, dhe, rrjedhimisht, në analizën financiare, duhej të ishin llogaritur kursimet në *cash* sipas deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit, si për shumat e deklaruara të kursyera, ashtu edhe për burimin e deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

**22.2** Konkluzioni i mësipërm i Komisionerit Publik mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur tashmë në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për interpretimin dhe zbatimin e nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ku Kolegji ka trajtuar në disa vendime detyrimin për deklaratim dhe vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore.<sup>23</sup>

**22.3** *Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga vëllezërit për periudhën 2011 - 2016*, në vlerësimin e Komisionerit Publik, të dhënat mbi të ardhurat e ligjshme të vëllait *\*\*\*.\*\*\** nga punësimi në Angli, nuk provojnë të kundërtën e barrës së provës. Komisioneri Publik vlerëson se Komisioni nuk duhet të kishte përfshirë në analizën financiare, të ardhurat e deklaruara të dhuruara nga vëllai *\*\*\*.\*\*\** për periudhën 2011-2014, për sa kohë që rezultojnë se të ardhurat e dokumentuara nga personi tjetër i lidhur, nuk janë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës në Britaninë e Madhe<sup>24</sup> dhe njëkohësisht edhe dhurimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Komisioni duhej të kishte përfshirë në analizën financiare të burimeve të ligjshme, vetëm të ardhurat e dhuruara nga vëllai *\*\*\*.\*\*\** i subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara nga institucionet financiare për periudhën 2015 - 2016, për të cilat nga verifikimi i të dhënave, rezultojnë se mbulohej me burime të ligjshme.

**22.4** Në vlerësim të sa më sipër, rezultojnë se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesat e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për periudhën 2003 - 2016. Kësaj difference, nëse do të shtohej dhe diferenca negative e trajtuar më sipër në pikën 18.16, do të thellonte ndjeshëm pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016.

<sup>21</sup> Referohuni f. 21-22 të vendimit të Komisionit.

<sup>22</sup> Totali i kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti në fund të vitit 2014, sipas deklaratave periodike vjetore, nuk përputhet me totalin e kursimeve të deklaruara për këtë periudhë nga subjekti në ILDKPKI në mars 2016 dhe me totalin e deklaruar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ.

<sup>23</sup> Referohuni në prg.42, vendim (JR) nr. 9/2018; prg.23, vendim (JR) nr.5/2019.

<sup>24</sup> Komisioni duket se nuk ka marrë në konsideratë zbritjet e taksave mbi të ardhurat e konfirmuara dhe shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë për *\*\*\*.\*\*\** dhe bashkëshorten e tij. Mbështetur në referencat e vendimit (JR) nr. 32/2019 të KPA-së, për periudhën 2011-2014, shpenzimet e jetesës për dy persona në shtetin anglez, llogariten në shumën 55.548 GBP.

22.5 Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në konkluzionet e mësipërme mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

### **III.B Për vlerësimin e aftësive profesionale**

23. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit, bazohet në aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësinë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

24. Referuar burimeve dhe procedurës së përcaktuar nga ky kuadër ligjor, duke përfshirë në këtë vlerësim dhe denoncimin e fakteve nga publiku, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar edhe shpjegime.

25. Për sa më sipër, bazuar në Raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga GPPP, rezultatet e hetimit administrativ dhe atyre shtesë të Komisionit, si dhe akteve të administruara për këtë qëllim, çështjet për të cilat subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime, ndër të tjera, janë si më poshtë:

**III.B.1. Të dhëna nga burime arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, pjesë të Raportit të rivlerësimit për subjektin Anton Martini, hartuar nga GPPP, si organi i vlerësimit të aftësive profesionale.**

**26. Ankesat e gazetarit \*\*\*,\*\*\*, drejtuar online (me email) Prokurorit të Përgjithshëm, protokolluar me nr. \*\*\*, datë 6.1.2014 dhe nr. \*\*\*, datë 6.1.2014, nga Zyra e Sektorit Publik, pranë Prokurorisë së Përgjithshme (subjekti i rivlerësimit në periudhën e trajtimit të ankesës ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.)**

26.1 Nga përmbajtja e Raportit të GPPP-së rezulton se shtetasi \*\*\*,\*\*\*, me profesion gazetar, më datë 30.12.2013, ora 3.00 p.m., ka drejtuar *online*/elektronikisht një ankesë në adresën e posaçme të *email*-it të Prokurorisë së Përgjithshme.

26.2 Kjo ankesë më datë 10.1.2014, ora 08.23 a.m., i ka kaluar për ndjekje në adresën *online*/elektronike z. A. M, duke u regjistruar me nr. \*\*\* prot, datë 6.1.2014, nga Zyra e Sektorit Publik.

26.3 Prokuroria e Përgjithshme, për sa më sipër, ka kërkuar informacion lidhur me ecurinë e hetimeve të këtij procedimi penal. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.1.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka dërguar informacionin prej tre fletësh të prokurorit A. M., “Mbi hetimet e procedimit penal nr.\*\*\*, të vitit 2013”.

26.4 Pasi është administruar ky informacion, nga prokurori i ngarkuar me ndjekjen e ankesës, është përgatitur informacion për eprorin e tij, lidhur me ecurinë e hetimit të procedimit, si dhe duke sqaruar se janë duke u kryer veprimet e nevojshme për sqarimin e rrethanave të faktit të kallëzuar.

26.5 Në vijim është vlerësuar se kallëzuesi është larguar jashtë territorit të vendit dhe ka dyshime se po e përdor kallëzimin si shkak për të përfutur azil në një shtet të BE-së. Në këto rrethana, duke mos pasur një adresë, i është lënë porosi Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun, t'i kthehet përgjigje në adresën e email-it, duke i shkruar se: [...] *procedimi është në fazën e hetimeve paraprake dhe në përfundim të hetimeve do të vihet në dijeni me zgjidhjen përfundimtare nga Prokuroria për Krime të Rënda [...]*.

26.6 Për sa më sipër, konstatohet se Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime pasi rezulton se: (i) ka vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore; (ii) janë të vakëta përpjekjet e subjektit për të thirrur dhe pyetur të dyshuarin kryesor, në fazën e hetimeve paraprake; (iii) ankuesi (pala e dëmtuar) ka referuar disa përpjekje për të marrë dijeni për ecurinë e hetimeve; (iv) nuk është njoftuar i dëmtuari (z.\*\*\*.\*\*\*,) për zgjatjen e afateve hetimore; (v) vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda, që ka dënuar të njëjtin autor, të së njëjtës vepër penale, për një tjetër episod, referon mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore nga ana e subjektit për këtë rast.

26.7 Vendimi nr. 231/2020 i Komisionit nuk ka bërë pjesë të arsyetimit trajtimin e ankesës së shtetasit \*\*\*.\*\*\*, objektin e ankesës apo detyrimet/përgjegjësitë e mundshme të subjektit në hetimin e këtij rasti. Ndërkohë, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për këtë rast janë të dokumentuara në përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ, në dosjen përkatëse të Komisionit.

26.8 Referuar përmbajtjes së vendimit nr. 231/2020, siç u tha më lart, rezulton se Komisioni pas propësimeve të subjektit të rivlerësimit, nuk arsyeton për rastin në fjalë, ndërkohë që anëtari në pakicë i trupit gjykues, duke përfshirë në argumentet përkatës edhe rastin konkret, është shprehur se: [...] *Për denoncimet nga publiku dhe ankesat e regjistruara në Prokurorinë e Përgjithshme, për të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, sipas vlerësimit tim si anëtar në pakicë, nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit*<sup>25</sup>[...].

26.9 Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti konkret, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, çmon se vlerësimi i Komisionit është marrë në interpretim të gabuar të nenit 59, pikat 1, 2, 3 dhe 4, lidhur me nenin 4, pika 2, dhe 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, në raport me mosveprimet dhe veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes.

26.10 Komisioneri Publik çmon se subjekti nuk provoi të kundërtën, për sa i është kërkuar në rezultatet e hetimit administrativ. Mangësitë/mosveprimet nga ana e subjektit të rivlerësimit janë të dukshme, dhe të tilla sa, së bashku me vlerësimin tërësor të çështjes, çojnë në një vlerësim të ndryshëm për qëllim të procesit të rivlerësimit, pasi rezultoi e provuar se:

---

25 Referohuni f.11 të vendimit të pakicës, paragrafi 8 dhe 8.1, në vendimin e Komisionit nr. 231, datë 24.3.2020.

- (i) Shtetasi \*\*\*.\*\*\*, me profesion gazetar, më datë 7.7.2013, ka bërë kallëzim pranë Seksionit të Vjedhjeve me Dhunë dhe Armë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë kundrejt shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*. Më datë 10.7.2013, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.\*\*\*, lidhur me veprën penale të “Shtrengimit me anë të kanosjes ose dhunës për marrjen e pasurisë”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b/1-25 të K. Penal, në bazë të akteve të referuara nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.
- (ii) Subjektit i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka kryer hetim në mënyrë shteruese të rastit dhe nuk ka vlerësuar rëndësinë e ngjarjes të denoncuar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në raport me rrezikshmërinë e veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal. Subjekti i rivlerësimit konstatohet se ka munguar në marrjen e veprimeve procedurale të nevojshme hetimore për hetimin e plotë të çështjes dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të veprës penale.
- (iii) Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit më datë 16.7.2013 ka marrë informacion nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, mbi identifikimin e të pandehurve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, dhe për numrat celularë në përdorim të tyre. Personat e përfshirë në kallëzimin e shtetasit \*\*\*.\*\*\* kanë rezultuar me një rrezikshmëri shoqërore të lartë. Shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në kohën e kryerjes së kallëzimit/veprës penale ka qenë efektiv i Gardës së Republikës, i pajisur me armatim përkatës. Për më tepër, ky shtetas ka rezultuar se pas ngjarjes së datës 6.7.2013, të kallëzuar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, është arrestuar në flagrancë nga organet e ndjekjes penale, për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” në dëm të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, të parashikuar nga neni 110 i K. Penal.
- (iv) Këto rrethana duhet të ndikojnë në kryerjen me shpejtësi të veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e plotë të kallëzimit të bërë dhe pyetjen me përparësi të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, shtetas i cili ka bërë kallëzimin penal. Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, datë 7.7.2013 dhe në vijim, nuk dokumentohet përpjekja e subjektit për të pyetur shtetasin \*\*\*.\*\*\*, mbi kallëzimin penal të bërë nga ana e tij, për më tepër në kushtet kur vepra penale kishte një karakter dhe rrezikshmëri të tillë.
- (v) Nuk rezulton, që edhe pas verifikimit të këtyre rrethanave që kishin të bënin me autorin e kallëzuar të veprës penale, subjekti i rivlerësimit të ketë urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me marrjen e të dhënave nga persona që kanë dijeni për rrethanat e kryerjes së veprës penale apo subjekteve të konsideruara nën hetim për kryerjen e veprës penale.
- (vi) Po ashtu, nga aktet në dosje, konstatohet se të dhënat e marra nga kompanitë celulare “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”, për numrat celularë të shtetasve të kallëzuar \*\*\*.\*\*\*, \*\*\*.\*\*\* dhe shtetasit \*\*\*.\*\*\*, të cilat konfirmojnë komunikimet e pretenduara nga shtetasi \*\*\*.\*\*\* me të kallëzuarit, janë administruar pas 3 muajve nga momenti i kallëzimit të këtij shtetasi<sup>26</sup>. Nuk dokumentohen përpjekje të subjektit të rivlerësimit për marrjen më përparësi në kohë të këtyre akteve.
- (vii) Vonesat procedurale të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e hetimeve të rastit konkret kanë vazhduar derisa pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda me datë 5.9.2014, më shumë

---

<sup>26</sup> Referohuni të dhënave në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.



se një vit pas kallëzimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë. Kallëzimi i bërë nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në datën 4.9.2014, ka si objekt të njëjtën veprë penale dhe si autorë të kallëzuar për kryerjen e veprës penale, të njëjtat subjekte, si në rastin e kallëzimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*.

- (viii) Subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit të dytë penal, për të njëjtët autorë dhe për të njëjtën veprë penale, i ka bashkuar dy procedimet e regjistruara mbi kallëzimet e shtetasit \*\*\*.\*\*\*
- (ix) Nga aktet në dosje rezulton se pasojat e veprës penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për marrjen e pasurisë”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b/1-25 të K. Penal, kanë qenë të një rrezikshmërie më të lartë në rastin e shtetasit \*\*\*.\*\*\*, duke shkaktuar pasoja më të rënda pasurore dhe sociale për personat e përfshirë.
- (x) Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës për gjykim ka paraqitur këtë procedim penal pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda më datë 10.3.2015, ku ka kërkuar dënimin e shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* për të dy procedimet penale të regjistruara.
- (xi) Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda, me vendimin nr. 65, datë 25.5.2015, ndër të tjera, ka konstatuar [...] *se në rastin objekt gjykimi nuk ka deklarime të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, sipas parashikimeve të nenit 294/1/b të K .Pr. Penale, pra nuk është realizuar pyetja e tij për faktin penal që ka referuar, kallëzuar në policinë gjyqësore [...].*
- (xii) Për sa më sipër, Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda, ka deklaruar të pafajshëm të pandehurit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, për veprën penale të kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, pasi nuk provohet se fakti ekziston në bazë të nenit 388/1/a të K. Pr. Penale dhe ka shpallur fajësinë e këtyre shtetasve vetëm për rastin e kallëzimit të shtetasit \*\*\*.\*\*\*.

26.11 Komisioneri Publik çmon se rezultatet e hetimit administrativ në këtë rast duhet të vlerësohen sipas nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar aftësi për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, nuk ka mbledhur provat e nevojshme të kërkuara me ligj, nuk ka treguar aftësinë për të marrë në pyetje, mosveprime të cilat kanë çuar në shmangien nga dënimi më i rëndë i autorëve të kryerjes së veprës penale në disa episode, kanë sjellë pasoja të rënda për shtetas të tjerë, të cilat eventualisht mund të ishin shmangur në rast të hetimit të plotë të kallëzimit të depozituar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\*, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut në rolin e organit të Prokurorisë.

26.12 Në konkluzion të sa më sipër, rrethanat e dala nga vlerësimi i këtij rasti, në vështrim dhe të vlerësimit tërësor të çështjes, kanë elemente të mjaftueshme për të konkluduar se ndodhemi në kushtet e aplikimit të nenit E, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

**27. Ankimi me nr. \*\*\*, datë 26.1.2015, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Inspektorit të Etikës pranë Prokurorit të Përgjithshëm (Subjekti i rivlerësimit në periudhën e trajtimit të ankesës ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.)**

27.1 Nga përmbajtja e Raportit të hartuar nga GPPP, rezulton se avokate \*\*\*.\*\*\* ka paraqitur ankesë drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Inspektorit të Etikës pranë Prokurorit të Përgjithshëm, nisur nga një shqetësim i saj ndodhur në emisionin e përjavshëm “\*\*\*”, në \*\*\*, pasi ka marrë një mesazh kërcënues në numrin e saj privat nga numri i telefonit në përdorim të një prokurori pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, subjektit të rivlerësimit z. Anton Martini, si dhe ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj këtij të fundit.

27.2 Ankuesja i ka bashkëlidhur ankimit të saj edhe tri deklaratatë të tre shtetasve, me të cilat konfirmohet fakti se me datë 8.1.2015 ditën e enjte, në zyrën e avokates \*\*\*.\*\*\*, është paraqitur z. \*\*\*.\*\*\*, së bashku me dy persona të tjerë, që nuk kishin lënë takim me avokaten. Gjatë takimit janë zhvilluar biseda me tone të larta dhe debate e fyerje.

27.3 Lidhur me trajtimin e ankimit, nga Raporti konstatohet se, për kryerjen e verifikimeve të nevojshme, është ngarkuar oficeri i Policisë Gjyqësore \*\*\*.\*\*\*, i cili më datë 26.1.2015, ka kryer këqyrjen e një aparati telefonik “Iphone 4s”, për të evidentuar mesazhe të shkëmbyera ndërmjet numrit 0xxxxxxx1, që i përket avokates \*\*\*.\*\*\* dhe numrit të telefonit 0xxxxxxx6<sup>27</sup>, që i përket subjektit të rivlerësimit Anton Martini.

27.4 Konstatohet se nga këqyrja e telefonit janë gjetur 7(shtatë) mesazhe, të cilat kanë rëndësi për ankesën dhe përmbajtja e tyre është pasqyruar integrale në Raportin e hartuar nga GPPP, duke filluar nga faqja 52 e këtij raporti.

27.5 Gjatë kryerjes së veprimeve verifikuese, GPPP ka konstatuar se në praktikën e rastit gjendet i administruar, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, z. Martini, një sqarim “Mbi ankesën e paraqitur nga znj. \*\*\*.\*\*\*”, drejtuar Inspektorit të Etikës, prej 4 faqesh.

27.6 Gjithashtu konstatohet se subjekti i rivlerësimit, Anton Martini, ka dorëzuar pranë Inspektorit të Etikës edhe një ankesë, “Mbi një histori të bërë publike në një emision televiziv, ku më parë rasti është sqaruar nga hetimi penal dhe nga gjykimet civile dhe penale, të cilën noter \*\*\*.\*\*\* e ka drejtuar para Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijeni Dhomës Kombëtare të Noterisë Tiranë.”

27.7 Nga GPPP është referuar se, pasi janë kryer veprimet e sipërpërshkruara dhe janë administruar aktet e mësipërme, ankimi është arkivuar më datë 21.1.2016, në gjendjen që janë aktet pa kthyer ndonjë përgjigje, duke mos vlerësuar se mbi këto të dhëna ka vend për kthim përgjigje.

27.8 Ndërkohë, edhe pse pjesë e raportit të GPPP-së, Komisioneri Publik konstaton se në vendimin nr. 231/2020 të Komisionit, nuk pasqyrohet trajtimi i ankesës në fjalë dhe as shqyrtimi i përgjegjësiave e mundshme të subjektit në këtë rast. Çështja është trajtuar në rezultatet e hetimit administrativ, me të cilat është njohur subjekti i rivlerësimit, ku Komisioni ka konkluduar se: [...] *pavarësisht shqyrtimit të ankesës në Prokurori të Përgjithshme, nga Inspektori i Etikës nuk rezultoi që ndaj subjektit të ketë filluar procedim disiplinor për këtë ankesë [...].* Arsyetimi që Komisioni ka përdorur vlerësohet se nuk passjell ndonjë pasojë në procesin e vlerësimit të etikës së subjekteve të rivlerësimit.

---

<sup>27</sup> I njëjti numër i deklaruar në përdorim zyrtar nga subjekti i rivlerësimit në pjesën 1 të formularit të shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016.

27.9 Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, si dhe vlerësimit tërësor të çështjes, çmon se rasti konkret dhe rrethanat e faktuara të kryerjes së tij, duhet të vlerësohen në raport me parashikimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se objekti i vlerësimit të aftësisë profesionale lidhet me vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve.

27.10 Komunikimet e dokumentuara në rastin në fjalë, që janë realizuar nga subjekti i rivlerësimit duke përdorur numrin zyrtar të telefonisë së lëvizshme të prokurorit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, konsiderohen të papërshtatshme dhe vijnë në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga neni 4 i ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare.

27.11 Komisioneri Publik vlerëson se rasti në fjalë duhet trajtuar si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të profesionit, parashikuar nga neni 103, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit duke realizuar komunikime të papërshtatshme dhe në shkelje të etikës, duket se ka kërkuar të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, premtime, sjellje kjo dhe në kundërshtim me rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve.<sup>28</sup>

**III.B.2. Të dhëna mbi mangësi procedurale nga trajtimi i dosjeve të përzgjedhura me short, pjesë të Raportit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, hartuar nga GPPP.**

**28. Dosja nr. 1, vendimi datë 1.9.2016 “Për mosfillimin e procedimit penal”, për kallëzimin nr. \*\*\* i datës 19.4.2016 (Subjekti i rivlerësimit për periudhën e hetimit të kryer ndaj materialit kallëzues ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.)**

28.1 Nga Raporti i vlerësimit profesional rezulton se aktet e kallëzimit penal janë referuar nga Komisariati i Policisë Shkodër, me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.4.2016. Mbi këtë bazë me datë 19.4.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*/2016.

28.2 Aktet e referuara me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.4.2016, të Komisarariatit të Policisë Shkodër, kanë të bëjnë me kallëzimin e shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, ndaj shtetasit \*\*\*.\*\*\*, për kundërvajtjet penale “Vetëgjyqësia” dhe “Kanosja”, parashikuar nga nenet 277 e 84 të K. Penal. Ushtrimi i ndjekjes penale është bërë nga subjekti i rivlerësimit, i cili është ngarkuar për ndjekjen e kallëzimit sipas shënimit të Drejtuesit të Prokurorisë, më datë 23.4.2016.

28.3 Subjekti i rivlerësimit, pasi ka marrë për shqyrtim aktet e kallëzimit, si dhe ka kryer disa veprime verifikuese, duke vlerësuar se në kallëzimin e dy shtetasve të mësipërm nuk konstatohen elemente të veprave penale, 5 muaj pas regjistrimit të procedimit penal, ka vendosur:

---

<sup>28</sup> [http://www.pp.gov.al/web/rregullat\\_e\\_etikes\\_dhe\\_sjelljen\\_e\\_prokuroreve\\_820.pdf](http://www.pp.gov.al/web/rregullat_e_etikes_dhe_sjelljen_e_prokuroreve_820.pdf)

- Të mosfillojë procedimin penal mbi bazën e materialeve të referuara më datë 19.4.2016 me nr. \*\*\* prot., nga Komisariati i Policisë Shkodër.
- Të njoh me këtë vendim Komisariatin e Policisë Shkodër, si dhe shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër.

28.4 Nga raportin e hartuar nga GPPP është konstatuar se:

1. Vendimi i mosfillimit të procedimit është marrë me vonesë të pajustificueshme duke kryer vetëm tri veprime hetimore (tri deklarimeve me data 2.5.2016, 12.5.2016 dhe 23.5.2016), bazuar në relacionin pa datë të oficerit të Policisë Gjyqësore.
2. Vendimi i mosfillimit nuk rezulton ti jetë njoftuar shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, pavarësisht se shtetasi \*\*\*.\*\*\* më datë 18.4.2016 është pyetur nga Policia Gjyqësore në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, duke ardhur në kundërshtim me nenin 291 të K. Pr. Penale.

28.5 Komisioni, i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi ka konkluduar se: [...] Për periudhën e vlerësimit të materialit kallëzues nga ana juaj, në dispozitat e K. Pr. Penale nuk ka pasur të përcaktuar afate kohore në lidhje me fazën e verifikimeve që mund të kryhen përpara se Ju të vendosnit për zgjidhjen ligjore që do të marrë materiali kallëzues. Por në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, të ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, është përcaktuar se “afati i verifikimit, të kallëzimit penal ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë” [...].

28.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] Është evident fakti, se në këtë rast, referuar udhëzimit nr.241, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, ku është përcaktuar si afat për verifikimin e kallëzimit, jo më shumë se 30 ditë, nuk e kam respektuar. Pavarësisht se ligji procedural penal në këtë periudhë nuk na kufizonte në afate për marrjen e një vendimi të tillë, udhëzimi i mësipërm ka qenë në fuqi. Vendimmarrja ime për këtë rast pas afatit 30-ditor, nuk ka sjellë pasojë për sa i përket të drejtave të kallëzuesit, pasi vendimi i është njoftuar kallëzuesit i cili nuk e ka ankimuar as në gjykatë dhe as te prokurori më i lartë. Vonesa e vendimmarrjes lidhur me rastin e mësipërm, nuk ka ardhur nga mosnjohja e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, por si rezultat i një dinamike në hetimin dhe gjykim e shumë rasteve që isha i ngarkuar me ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, në këtë periudhë dhe prioriteteve që ndryshonin sipas ngjarjeve që trajtonim [...].

**29. Dosja nr. 2, Procedimi penal nr. \*\*\* i vitit 2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, hetimet e të cilit janë pushuar në datë 20.9.2013** (Subjekti i rivlerësimit për periudhën e hetimit të kryer ndaj materialit kallëzues ka kryer detyrën e prokurorit ne Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.)

29.1 Nga Raporti i vlerësimit profesional rezulton se procedimi penal nr.\*\*\*/2013 është regjistruar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda më datë 27.5.2013, mbi bazën e materialeve

të referuara nga Sektori Kundër Narkotikëve në Drejtorinë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2 i K. Penal.

29.2 Po më datë 27.5.2013, pas vendimit për regjistrimin e këtij procedimi penal, subjekti ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore. Më datë 20.9.2013, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur:

- *Pushimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2013, pasi fakti nuk ekziston.*
- *Të njohë me këtë vendim Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga e cila ka ardhur materiali referues.*

29.3 Nga GPPP është konstatuar se:

- *Për sa i përket zgjidhjes së procedimit penal me pushimin e hetimeve, vendimmarrja e prokurorit është e drejtë, por konstatohet se arsyetimi i subjektit nuk përputhet me dispozitën ligjore për të cilën është vendosur pushimi i hetimeve.*
- *Në pikën 2 të vendimit të pushimit është cituar: “të njohë me këtë vendim Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, por konstatohet se vendimi i pushimit nuk i është dërguar me shkresë kësaj drejtorie apo personit ndaj të cilit janë zhvilluar hetime.*

29.4 Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ lidhur me këtë çështje, ka vlerësuar se: [...] (i) *Konstatohet se materiali referues nuk ka ardhur nga Drejtoria Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, por nga Departamenti Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe si rrjedhojë, në pikën 2 të vendimit të pushimit, duhej të citohej Drejtoria, e cila ka bërë referimin;* (ii) *Po ashtu konstatohet se vendimi i pushimit nuk i është dërguar me shkresë kësaj Drejtorie, por as Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, të cituar në vendimin e pushimit [...].*

29.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] (i) *Sektori kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve që kishte referuar aktet, bënte pjesë brenda Drejtorisë Kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Gabimisht jam shprehur për Drejtorinë kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, por në fakt ishte Sektori kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Drejtorinë kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.* (ii) *Oficeri i Policisë Gjyqësore, z. \*\*\*.\*\*, i cili referoi rastin dhe kreu hetimet deri në fund të tyre, ishte oficer i Policisë Gjyqësore në Sektorin kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Drejtorinë kundër Krimin të Organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ai është njohur me vendimmarrjen time, pasi ishte oficeri i Policisë Gjyqësore që hetoi rastin. Nuk është në praktikën tonë që të dërgojmë njoftime për vendimmarrjet tona, kur of. i Pol. Gjyqësore që ka referuar rastin, ka kryer vetë hetime dhe është në dijeni të gjitha rezultateve të hetimit [...].*

**30. Dosja nr. 3, Procedimi Penal nr.\*\*, viti 2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, hetimet e të cilit janë pushuar në datën 27.12.2013 (Subjekti i rivlerësimit për periudhën e hetimit të kryer ndaj materialit kallëzues ka kryer**

*detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.)*

30.1 Nga Raporti i vlerësimit profesional rezulton se kallëzimi penal është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda më datë 5.4.2013, mbi bazën e materialit të referuar nga Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, për veprën penale “Ndhima për kalimin e paligjshëm të kufirit”, të kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga neni 298 dhe 333/a i K. Penal.

30.2 Ushtrimi i ndjekjes penale fillimisht është bërë nga prokurori \*\*\*.\*\*\*, i cili me urdhër 8.4.2013, ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore duke ngarkuar katër oficerë të Policisë Gjyqësore, për kryerjen e tyre deri në datën 15.5.2013. Më datë 17.7.2013 është vendosur zëvendësimi i prokurorit \*\*\*.\*\*\* me subjektin e rivlerësimit.

30.3 Nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore \*\*\*.\*\*\*, pasi janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara në datën 27.12.2013, është përpiluar relacion për përfundimin e hetimeve të procedimit penal me të cilin ka sugjeruar para prokurorit pushimin e hetimeve. Si përfundim, prokurori i çështjes, më datë 27.12.2013, ka vendosur pushimin e procedimit penal, sipas nenit 328/1, germa “a”, të K. Pr. Penale.

30.4 Nga GPPP është konstatuar se: [...] *Në pikën 2 të vendimit të pushimit është cituar: të njohë me këtë vendim Departamentin e Kufirit dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, por konstatojmë se vendimi i pushimit nuk i është dërguar me shkresë kësaj Drejtorie apo personit ndaj të cilit janë zhvilluar hetime [...]. Sa më sipër është vlerësuar dhe nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ.*

30.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, për të njëjtën mangësi procedurale të konstatuar dhe në dy rastet e tjera, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] *E drejta e njoftimit, lidhet thelbësisht me të drejtën e ankimit, për pasojë Policia e Shtetit nuk legjitimohet të ankimojë një vendim pushimi, të cilin e ka referuar ajo dhe është involvuar në kryerjen e veprimeve hetimore [...].*

30.6 Vendimi nr. 231/2020 i Komisionit nuk ka një paraqitje të 3 (tre) rasteve të sipërtrajtuara, lidhur me mangësitë procedurale të konstatuara dhe për detyrimet/përgjegjësitë e mundshme të subjektit në hetimin e këtij rasti.

30.7 Komisioneri Publik çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për të tria rastet e sipërtrajtuara nuk janë bindëse dhe të mbështetura ligjërish. Mosrespektimi i afateve kohore për pushimin e procedimeve penale dhe mosnjoftimi i palëve të përfshira në një kallëzim/procedim penal për mosfillimin ose pushimin e procedimit, është në shkelje të detyrimeve ligjore të përcaktuara nga neni 291 i K. Pr. Penale dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, që kanë qenë në fuqi në periudhat përkatëse.

30.8 Komisioneri Publik i gjen shpjegimet e subjektit [...] *se e drejta e njoftimit lidhet thelbësisht me të drejtën e ankimit dhe se mosnjoftimi nuk ka sjellë pasoja për palët [...], si të pabazuara.*

30.9 Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik, nisur dhe nga roli që duhet të luajë organi i Prokurorisë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik, çmon se mosnjoftimi i palëve të përfshira në procedim, përveçse shkakton pasiguri juridike për

këto subjekte, vjen në kundërshtim dhe me të drejtën e informimit të tyre për t'u njohur mbi veprimet e kryera dhe vendimet përfundimtare të marra nga organet që ligji u ngarkon detyrimit për t'i trajtuar çështjet brenda afateve përkatëse kohore.

30.10 Komisioneri Publik, në analizë të fakteve dhe rrethanave të konkluduara edhe nga GPPP mbi 3 (tre) dosjet e shortuara, si dhe në vlerësim tërësor të çështjes, çmon se Komisioni duhej të kishte arsyetuar mbi gjetjet e përsëritura të këtyre rasteve, duke konstatuar se për to gjen zbatim neni 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

### *III.B.3. Të dhëna mbi denoncimet*

#### **31. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2019, depozituar në Komision pas zhvillimit të seancës dëgjimore datë 10.12.2019**

31.1 Denoncuesja, shtetësja \*\*\*.\*\*\*, ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka kryer shkelje të rënda, pasi ia ka hequr dosjet hetimore disa prokurorëve, duke ia kaluar prokurorëve të tjerë, pa dhënë dorëheqjen të parët dhe pa një vendim që të justifikonte kalimin e dosjeve.

31.2 Komisioni administroi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër informacion mbi të gjitha rastet e zëvendësimit të prokurorit dhe të gjitha vendimet përkatëse, që i përkasin periudhës 10.11.2017 - 6.6.2018, gjatë së cilës drejtues i komanduar i kësaj Prokurorie ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini. Po ashtu Komisioni administroi dokumentacionin mbi bazën e të cilit janë arsyetuar vendimet për zëvendësimin e prokurorit, rast pas rasti, si dhe nëse ka pasur raste në të cilat prokurori i zëvendësuar të ketë paraqitur ankesë kundër vendimit të zëvendësimit.<sup>29</sup>

31.3 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 16.12.2019, ka informuar dhe dërguar bashkëlidhur informacionit 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vendime të marra nga subjekti i rivlerësimit për ndryshimin e prokurorit të çështjes, vendime që i përkasin periudhës rreth 7-mujore gjatë së cilës subjekti ka qenë në cilësinë e drejtuesit të kësaj Prokurorie.

31.4 Komisioni, pas analizimit të plotë të dokumentacionit të administruar, në rezultatet shtesë të hetimit administrativ, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime, si dhe të sjellë dokumentacion justifikues, lidhur me: [...] **(1) kriteret organizative/ligjore mbi bazën e të cilave ka bërë riorganizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (referuar urdhrin nr.2, datë 16.1.2018) - si pasojë e të cilit kanë ardhur dhe disa zëvendësime prokurorësh; (2) procedurat e shortit të zhvilluara për rishpërndarjen e dosjeve, mbi bazën e të cilit janë bërë vendimet e zëvendësimit, si edhe nëse ka pasur trajtim të njëjtë të prokurorëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit dhe seksionin përkatës; (3) Gjithashtu, nga verifikimi i rasteve të zëvendësimit konstatohet se, në një rast zëvendësimi është bërë pa short, për shkak të kërkesës së të pandehurve, shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*. Dhe kërkesës për dorëheqje nga vetë prokurori i çështjes z. \*\*\*.\*\*\* nga përfaqësimi i akuzës në gjyq që ka të bëjë me të njëjtën çështje [...].**

<sup>29</sup> Referohuni shkresave të Komisionit nr.\*\*\* prot., datë 12.12.2019 dhe shkresës nr.\*\*\* prot., datë 18.12.2019.

31.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, ndër të tjera, ka pretenduar se: [...] (i) Në përfundim të vitit 2017, pasi u nxorën dhe u përpunuan statistikat mbi ngarkesën që kishte pasur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe problematikat e konstatuara gjatë atij viti, u vlerësua, me qëllim përmirësimin e punës për vitin në vijim, riorganizimi i seksioneve brenda Prokurorisë. Në këto kushte, më datë 16.1.2018, me urdhër nr.02. me cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, bazuar në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 2, datë 19.12.2016, “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”, dhe nr. 3, datë 29.11.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori”, urdhërova riorganizimin e seksioneve dhe ripozicionimin si Drejtuesit e Seksioneve, Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore; (ii) Lidhur me mënyrën e ndarjes së procedimeve penale gjatë periudhës që kam qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dua t’ju sqaroj se dosjet dhe materialet e tjera kallëzuese apo referuese janë hedhur në short elektronik. Në raste të rralla që ka pasur problem teknik sistemi (i cili monitorohet nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm), materialet janë hedhur në short manual midis prokurorëve të seksionit, sipas grup-veprave penale. Gjithashtu, në rastet e largimit të prokurorëve, komandimit të tyre në Prokurori të tjera apo në rastet e ndryshimit të seksioneve apo heqjes dorë të prokurorit nga një çështje e caktuar, dosjet hidhen në short manual, pasi sistemi elektronik nuk parashikon rihedhje në short elektronik; (iii) Lidhur me trajtimin e kërkesave të shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\* (të pandehur) dhe të prokurorit z. \*\*\*.\*\*\*, për heqjen dorë nga vazhdimi i përfaqësimit të akuzës në gjyq, mendoj se e kam trajtuar me objektivitet dhe palët kanë ardhur në dijeni të vendimmarrjes time, vendimmarrje e cila ka shoqëruar përfaqësimin e akuzës në gjyq nga një prokuror tjetër, e konkretisht nga prokurori z. \*\*\*.\*\*\* në seancën e radhës, ku ankuesit duhet të ishin të pranishëm [...].

31.6 Në përfundim, lidhur me denoncimin, Komisioni pasi i ka konsideruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit dhe përgjigjeve në seancën e datës 27.1.2020, ka konkluduar se: [...] Për më tepër, në kushtet kur denoncuesi nuk paraqet rrethana apo fakte konkrete mbi bazën e të cilave të provohet dyshimi për qëllimin e fshehur në përpilimin e këtyre vendimeve të zëvendësimit të prokurorit dhe në kushtet kur as Komisioni nuk evidentoi situata të dyshimta në shpërndarjen e dosjeve dhe përpilimin e vendimeve të zëvendësimit, trupi gjyqësor vlerëson se trajtimi i këtij denoncimi merr një peshë specifike më të vogël, pasi ka të bëjë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë etiko-profesionale të tij apo integritetin dhe figurën si prokuror, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka qenë vetëm për rreth 7 muaj drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në rreth 21 vite karrierë si prokuror - periudhë rivlerësimi [...].<sup>30</sup>

31.7 Komisioneri Publik vlerëson se rezultatet e hetimit shtesë administrativ mbi këtë denoncim, në asnjë rast nuk mund të trajtohen si të një peshe specifike më të vogël, me arsyetimin se kanë të bëjnë me vlerësimin e cilësive drejtuese të subjektit të rivlerësimit dhe jo me aftësitë e tij etiko-profesionale si prokuror. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, Kushtetuta, ligji nr. 84/2016 dhe ligji nr. 96/2016, në asnjë moment nuk kanë parashikuar në kriteret, burimet dhe nivelet e vlerësimit, vlerën primare të cilësive si magjistrat/prokuror i thjeshtë apo si magjistrat/prokuror drejtues në raport me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit

<sup>30</sup> Referohuni f.49, paragrafi 49.20, i vendimit të Komisionit.



profesional apo kohën e ushtrimit të detyrës, përkundrazi ka përcaktuar qartazi dispozitat mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi në të dyja rastet.

31.8 Komisioneri Publik vlerëson se çdo rrethanë që lidhet me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, pavarësisht kohës së shkurtër në detyrë, ka rëndësinë e vetë dhe duhet të ketë vlerën e provës. Neni E i aneksit të Kushtetutës përcakton se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen rivlerësimit të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Ky qëndrim i Komisionerit Publik mbështetet dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit në vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.<sup>31</sup>

31.9 Ligji nr. 96/2016, në pjesën IV, Vlerësimi i Magjistratit, neni 68, parashikon se qëllimi i vlerësimit të magjistratit është të vendosë standarde të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve (68/d), të identifikojë magjistratët që mund të kenë aftësi të veçanta profesionale për sistemin e drejtësisë (68/g) apo të kontribuojë në përmirësimin e strukturës organizative të gjykatave dhe prokurorive (68/dh). Ligji nr. 96/2016, në Seksionin II, neni 80, pika 3, përcakton qartazi kriteret për vlerësimin e veprimtarisë së magjistratit/kryetar, ku dhe specifikon kriteret mbi të cilat maten aftësitë drejtuese dhe organizative të kryetarit të Prokurorisë.

31.10 Komisioneri Publik çmon se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve shtesë të hetimit. Rezultatet e hetimit shtesë të Komisionit mbi zëvendësimin e rasteve të prokurorëve dhe ndarjes në seksione të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, më së paku duheshin vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi e provuar se:

- Udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” në kreun II, pika 2, përcakton: [...] *se procedura e hedhjes së shortit duhet të jetë e monitorueshme, e dokumentuar dhe transparente, nëpërmjet njoftimit paraprak për zhvillimin e tij [...].* Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, nuk dokumentoi procedurat e hedhjes së shortit, procedura për të cilat Komisioni vetë ka konstatuar [...] *që statistikisht nuk ka të ngjarë që në 12 raste të zëvendësimit që i referohen shortit manual, të përzgjidhet me short i njëjti prokuror. Gjithashtu duket se statistikisht nuk ka të ngjarë që nga 13 dosje për të cilat zëvendësimi është bërë për shkak të caktimit të dy prokurorëve në GPPP, në 10 prej tyre të përzgjidhet i njëjti prokuror [...]*

- Ligji nr. 97/2016, neni 21, pika 1, Seksionet e prokurorive, ndër të tjera, parashikon se: [...] *Në çdo prokurori, për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, drejtuesi i Prokurorisë krijon seksione me jo më pak se tre prokurorë, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve [...].* Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, nuk dokumentoi mendimin e mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve të strukturës përkatëse, e cila sipas nenit 55/2/c të ligjit nr. 97/2016, jep mendim për ngritjen e seksioneve, për strukturën dhe përbërjen e tyre.

<sup>31</sup> Referohuni pikës 26.1.1, prg.26 i vendimit (JR) nr. 21/2019 të KPA-së.

#### **III.B.4. Të dhëna lidhur me denoncime të tjera**

**32.** Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

32.1 Komisioneri Publik, nisur dhe nga orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku në vendimin (JR) nr. 21/2019, prg.26, pika 26.1.1, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, ndër të tjera, përcakton se: [...]Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016[...].

32.2 Për sa më sipër, Komisioneri Publik, në pamundësi të mbledhë prova ai vetë, sjell në vëmendje të Kolegjit, përveç denoncimeve të publikut për këtë subjekt rivlerësimi, të administruara ndërkohë nga vetë Kolegji, edhe aktin në vijim:

(i) Denoncim i protokolluar më datë 3.6.2020, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, ku, ndër të tjera, pretendohet për komunikime telefonike të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në procedime penale, si dhe referon një numër shkresash të identifikuar me numër protokollit dhe datë, të cilat sipas denoncuesit kanë të bëjnë me ankesa të prokurorëve në Prokurorinë Shkodër, lidhur me rastet kur janë zëvendësuar nga subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës së Drejtuesit të kësaj Prokurorie.

32.3 Komisioneri Publik, në përfundim të sa më sipër, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ mbi vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, çmon se subjekti i rivlerësimit, me shpjegimet dhe provat e paraqitura, nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

32.4 Komisioneri Publik, në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se konkluzioni i Komisionit edhe për këtë element të rivlerësimit është i cënueshëm, pasi ai bazohet në një vlerësim jo të drejtë të provave dhe ligjit të zbatueshëm, duke mos marrë po ashtu në konsideratë të posaçme ndikimin që ka procesi i rivlerësimit në rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, qëllim i përcaktuar në nenin 179/b, pika 1, të Kushtetutës.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**33.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

**34.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**35.** Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

**36.** Komisioneri Publik kërkon, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**